



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201900407/2

Tiranë ___/___/2019

Lënda: Marrja e masave për zbatimin korrekt të rekomandimit nr. K1/i22-2 prot. datë 15.6.2017, të institucionit të Avokatit të Popullit.

MINISTRISË SË DREJTËSISË

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PËRMBARIMIT
GJYQËSOR

TIRANË

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit shpreh shqetësimin për pamjet e dënueshme të përplasjes ndërmjet Zyrës së Përmbarimit, Policisë së Shtetit dhe banorëve së bashku me fëmijët e tyre në zonën e shkollës së mesme të përgjithshme "Petro Nin Luarasi" të publikuara në mediat vizive.

Më lejoni, që në mënyrë të përmbledhur t'Ju prezantoj si vijon:

Institucioni i Avokati i Popullit në vitin 2017, për rastin e veçantë të bërë publik, në gazetën "SOT", me titull "Policia dhe përmbarimi nxjerr në mes të katër rrugëve fëmijën paraplegjik" filloi shqyrtimin e çështjes me nismën e vet dhe kreu një hetim të pavaruar për këtë rast. Ndërmjet të tjerave, institucioni ynë i kërkoi Zyrës së Përmbaruesit Privat, të gjitha procedurat e ndjekura për ekzekutimin e vendimit të gjykatës.

Në përfundim të hetimit, u evidentua, se Zyrat e Përmbarimit Shtetëror/Privat, gjatë kryerjes së veprimeve për ekzekutimet e vendimeve gjyqësore, në rastet kur drejtëpërdrejt ose jo, shkelen të drejtat e fëmijëve, si rrjedhojë e mungesës

së informacionit për legjislacionin në fuqi në këtë fushë, nuk merrnin masa për të ndjekur procedurat përkatëse, me qëllim garantimin e të drejtave e fëmijëve nga strukturat përgjegjëse në nivel vendor.

Në këtë kuptim, në shkresën zyrtare me nr. K1/I2202, datë 15.6.2017, institucioni i Avokatit të Popullit adresoi rekomandimin përkatës për Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarrimit, për marrjen e masave të nevojshme gjatë ekzekutimit të vendimeve të detyrueshme, për njoftimin rast pas rasti të Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve, në njësitë e qeverisjes vendore, duke garantuar ligjërisht interesin më të lartë të fëmijëve, ku drejtëpërdrejt ose jo, fëmijëve ju shkelen të drejtat e tyre, gjatë kryerjes së procesit të ekzekutimit të një vendimi gjyqësor.

Në përgjigje të rekomandimit të Avokatit të Popullit, në shkresën zyrtare me nr.1464/1 datë 28.6.2017, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit shprehu dakordësinë për zbatimin e rekomandimit, si dhe garantoj për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi, për t'i ardhur në ndihmë fëmijëve me faktor risku më të lartë.

Për sa më sipër, institucioni i Avokatit të Popullit vlerësoi gadishmërinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit, si institucioni përgjegjës, që do të ndërmarrë hapat ligjorë e proceduralë, që raste të tilla të parandalohen në kohë, minimizohen e të mos përsëriten më.

Por, përsëritja e ngjarjes në zonën e Shkollës së Mesme të Përgjithshme “Petro Nini Luarasi” dëshmoi për moszbatimin korrekt të rekomandimit të institucionit të Avokatit të Popullit nga institucionet përgjegjëse, konkretisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit.

Në këtë kuptim, në frymën edhe të legjislacionit të ri të mbrojtjes së fëmijës, drejt një qasjeje të bashkëpunimit, bashkërendimit dhe koordinimit ndërsektorial në nivel qendror dhe vendor, për zbatimin korrekt të këtij legjislacioni, institucioni i Avokati i Popullit, kërkon të na informoni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve nga institucionet përgjegjëse është pjesë e raportimit periodik të institucionit të Avokatit të Popullit pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, sipas vendimit nr.49/2017, të Kuvendit, “Mekanizmi për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”, si dhe do të vlerësohet edhe nga grupi i ngritur për këtë qëllim nga kryetari i Kuvendit.

Lutemi, gjeni bashkëlidhur një kopje të rekomandimit nr. K1/I22-2, datë 15.6.2017.

Në përfundim, mbrojtja nga çdo formë e dhunës, neglizhencës dhe forcimi i shëndetit fizik e emocional të fëmijëve nuk është vetëm një komponent kyç i promovimit të të drejtave të tyre, duke përfshirë interesin më të lartë, por ka edhe përparësi të jashtëzakonshme. Kjo u jep fëmijëve mundësinë më të mirë për të jetuar një jetë të shëndetshme dhe të përmbushur, të rriten për të qenë adultë të lumtur dhe produktivë, u mundëson të jetojnë fëmijërinë e tyre, por passjell përfitime shumë të mëdha edhe për shoqërinë.

Gjithashtu, për një shqyrtim sa më objektiv të ngjarjes së ndodhur dhe, për të bërë të mundur kryerjen e misionit tonë kushtetues, mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme apo të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, kërkojmë nga Ju, që brenda 10 ditësh, të na dërgoni një informacion të hollësishëm dhe shpjegimet përkatëse, lidhur me masat që janë ndërmarrë dhe janë planifikuar për t'u realizuar në vazhdimësi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe në vijimësinë e bashkëpunimit në funksion të garantimit të interesit më të lartë të fëmijëve.

K O M I S I O N E R

Nejla PEKA

Konceptoi: M.Tyli